

## ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

Prishtinë

# ANKESË

**Operatori Ekonomik:** EKO-ELECTRONICS SH.P.K.

**Autoriteti Kontraktues:** Policia e Kosovës

**Aktiviteti i Prokurimit:** "Furnizim me Material Metalik – Ritender"

**Nr. i Prokurimit:** 214/30400-25-11090-1-2-1

---

## ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP) – PRISHTINË

### ANKESË

**Operatori Ekonomik:** EKO-ELECTRONICS SH.P.K. **Autoriteti Kontraktues:** Policia e

Kosovës **Aktiviteti i Prokurimit:** "Furnizim me Material Metalik – Ritender" **Nr. i**

**Prokurimit:** 214/30400-25-11090-1-2-1

---

## I. OBJEKTI I ANKESËS

Operatori Ekonomik (OE) EKO-ELECTRONICS SH.P.K. paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të AK-së mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, datë **04.02.2026**, me të cilin OE është eliminuar padrejtësisht për:

- **Pjesa A:** Pozicionet 18, 19, 24, 25, 26, 27, 28
- **Pjesa B:** Pozicionet 6, 12, 13
- **Pjesa C:** Pozicioni 3 – Set koke kaçavide L25 mm, 32 pjesë

## II. SHKELJA PROCEDURALE: Dështimi i AK-së për rishqyrtim meritore

Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Nenin 108/A (pika 10) të LPP-së**. AK nuk ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore të dorëzuara me datë 30.01.2026, por thjesht ka përsëritur arsyetimin e eliminimit fillestar. AK ka dështuar të argumentojë **pse** pretendimet tona ankimore janë të pabazuara duke e bërë procesin e rishqyrtimit krejtësisht fiktiv.

## III. ARGUMENTIMI I SHKELJEVE MATERIALE

**1. "Fotografia e Paketimit" – Kriter i paqenë në Dosjen e Tenderit (DT)** AK pretendon se nuk kemi ofruar "foto të paketimit (kutisë)".

- **Fakti:** DT ka kërkuar "Katalog/Broshurë me përshkrim të detajuar". Ne kemi ofruar katalogun ku specifikohet "Kuti 100 copë".
- **Shkelja:** Kërkesa për foto specifike të kutisë është **shtim kriteri pas hapjes së ofertave**.

- Paketimi është aspekt tregtar/logjistik dhe nuk ndikon në përputhshmërinë teknike
- **“paketimi nuk është specifikë teknike”**
- Përshkrimi në ofertë është zotim ligjor. AK ka shkelur **Nenin 7** dhe **Nenin 59** të LPP-së duke interpretuar specifikimet jashtë asaj që është shpallur në DT.

## 2. Pozicioni 6 (Pjesa B) – Lajthitje Formale (Hugo vs. Yato)

- **Argumenti:** Mospërputhja e emrit të prodhuesit është një pasaktësi grafike/formale që nuk ndikon në parametrat teknikë.
- **Detyrimi i AK-së:** Sipas **Nenit 72**, AK ishte i obliguar të kërkonte sqarim për këtë mospërputhje formale para eliminimit. AK ka zgjedhur eliminimin e ofertës më të lirë për një gabim shkrimi, duke dëmtuar parimin e ekonomicitetit (**Neni 1**).

## 3. Interpretim Arbitrar i "Set 32 pjesë" (Pozicioni 3, Pjesa C)

- **Fakti:** DT kërkon "Set koke kaçavide... 32 pjesë". Seti ynë ka 32 pjesë totale (koka + aksesore funksionale).
- **Shkelja:** AK ka interpretuar se të 32 pjesët duhet të jenë "vetëm koka", kriter ky që nuk figuron në DT. Ky interpretim i ngushtë pas hapjes eliminon konkurrencën dhe shkel parimin e proporcionalitetit.

## IV. SHKELJET LIGJORE

Me veprimet e tij, AK ka shkelur:

- **Neni 1** (Ekonomiciteti), **Neni 7** (Barazia në trajtim), **Neni 28** (Specifikimet teknike), **Neni 59** (Ekzaminimi i tenderëve) dhe **Neni 72** (Sqarimi i tenderëve).

## V. KËRKESA PËR PANELIN E OSHP-së

Të aprovojë ankesën si të bazuar.

1. Të anulojë vendimin e AK-së për eliminim.
2. Të urdhërojë AK-në që lëndën ta kthejë në ri-vlerësim dhe të bëjë vlerësimin konform kriterëve të shpallura në DT, duke aplikuar Nenin 72 për çdo paqartësi formale **EKO-**
- 3.
4. **ELECTRONICS SH.P.K.**  
Përfaqësues: Eranda Gashi  
Datë: 12.02.2026

